

Përurohen dy projekte infrastrukturore - 28 nëntor 2011

<http://kk.rks-gov.net/kacanik/News/Perurohen-dy-projekte-infrastrukturore.aspx>



Me rastin e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit Kombëtar në komunën tonë janë inauguruar dy projekte kapitale



Me rastin e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit Kombëtar në komunën tonë janë inauguruar dy projekte kapitale. Në fshatin Gajre i është prerë shiriti rrugës së asfaltuar, ndërsa në qytet është inauguruar ura mbi lumin Neredime. Asfaltimi i segmentit të parë të kësaj rruge është pjesë e projektit të asfaltimit të rrugës Magjistrale-Gajre-Ivajë. Ky segment ka kushtuar 134.370 euro dhe është financuar nga buxheti komunal. Shiritin e rrugës së Gajrës e kanë prerë z. Heset Loku, nënkryetar i Komunës së Kaçanikut; z. Xhelal Gashi, kryesues i KK-së dhe z. Fadil Çallaku, veteran i UÇK-së nga fshati Gajre. Kryetari Zharku ka thënë me këtë rast se ky segment i asfaltuar është vetëm fillimi i realizimit të projektit të rrugës Gajre-Ivajë. Ai tha se asfaltimi i kësaj rruge e lehtëson qarkullimin e automjeteve dhe njerëzve, ndërsa meritat për realizimin e këtij projekti ia ka atribuuar dëshmorëve dhe luftës së UÇK-së, për faktin se, siç tha ai, liria erdhi në sajë të rënies heroike të dëshmorëve, të cilët i kujtojmë me pietet të lartë dhe lufta e UÇK-së, e cila hapi rrugë për sendërtimin e vendit dhe krijimin e kushteve për jetë më të mirë të gjithë qytetarëve. Për

investimin në këtë projekt Muhamet Çallaku, administrator i Gajrës, e ka falënderuar Komunën. Banorët e Gajrës në shenjë mirënjohje i kanë ndarë dy dhurata Komunës. Ndërkaq, përrurimin e urës



mbi Neredime e kanë bërë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, koordinatori i projektit zviceran LOGOS z. Norbert Piljs dhe z. Shkelzen Raka, djali i dëshmorit Ismail Raka. Ky projekt është bashkëinvestim i LOGOS-it dhe Komunës së Kaçanikut. Për këtë projekt LOGOS-i ka dhuruar 50 mijë euro, ndërsa Komuna 27.602 euro. Ura e ndërtuar është e gjatë 17 metra, e gjerë 6 metra, e ka ndriçimin dhe me shtigje këmbësorësh në të dyja anët e saj.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku e falënderoi LOGOS-in dhe popullin zviceran për këtë investim, si dhe popullin amerikan për ndihmat e vazhdueshme para, gjatë dhe pas luftës. Ndërkaq koordinatori i LOGOS-it, z. Norbert Piljs, ka theksuar se Qeveria Zvicerane ka investuar në këtë projekt, ndërsa urën e ka ndërtuar Komuna e Kaçanikut. “Ne kemi punuar edhe me disa komuna në regjionin e Gjilanit, por komuna e Kaçanikut është ajo e cila i bënë punët më mirë dhe më shpejtë”, ka shprehur komplimentet e tij z. Piljs. Ndërkaq

Për nder të festave të nëntorit janë bërë edhe homazhe te Varrezat e Dëshmorëve, ndërsa është mbajtur edhe një akademi solemne dhe është hapur një ekspozitë figurative.